



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 76 Datë 31-07-2025

**PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE
TARIFAT VENDORE NË VLERËN 243,812.5 LEKË DHE KRYERJEN E PAGESËS
PËR KTHIMIN E SHUMËS NË PO KËTË VLERË PËR LLOGARI TË "TELEKOM
ALBANIA", sha, ("ONE Telecommunications")**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin 115/2024 datë 03.12.2024 "Për buxhetin e vitit 2025", udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, si dhe VKB nr. 176 datë 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë", mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore (në zërin qera trualli administrimi i pyjeve), në vlerën 243,812.5 lekë, (paguar më tepër).
2. Të miratojë kryerjen e pagesës për kthimin e shumës në po këtë vlerë për llogari të "Telekom Albania", sha, ("One Telecommunications") me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET

Programi AC122 Prod. V426AAB 00 04260 05 Art. 6040000 243,812.5 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Pro 27

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 31-07-2025

